



Çlirimi i
Iranit



TUBIM PËR IRANIN E LIRË 2019, SHQIPËRI

MARYAM RAJAVI:

DO TA RIFITOJMË IRANIN!



Tubim për Iranin e Lirë 2019 në Kampin “Ashraf 3”, Shqipëri

IRANI: PUSHTETI I ALTERNATIVËS!



The Washington Times

Shkruar në gazetën “The Washington Times”
E enjte • 25 korrik • 2019

ASHRAF-3, Shqipëri — Ditën e shtunë, grupi opozitar më i madh i Iranit hapi dyert e shtëpisë së tij të re me një sërë vlerësimesh të dhëna nga liderët politikë si nga krahu i majtë ashtu edhe i djathtë, të cilët kishin ardhur nga thujse 50 vende për të përkrahur grupin dhe qëllimet e tijKampi “Ashraf-3”, ende i papërfunduar, shtrihet në një sipërfaqe të madhe, që para 30 muajsh ishte tokë bujqësore, midis kryeqytetit shqiptar, Tiranës dhe bregdetit të Adriatikut. Në këtë kamp strehohen më shumë se 3,000 disidentë iranianë që i përkasin grupit “Muxhahedinët e Popullit të Iranit” “Mujahedeen-e-Khalq”, i njohur si MEK. Duke qenë se është ndërtuar së fundmi, kampi “Ashraf-3” nuk shfaqet në hartë. Çimentoja nuk ishte tharë ende përreth bazës ku ishin ngritur flamujt dhe punëtorët po lyenin parmakët e një ure, kur në kamp mbërritën më shumë se 350 personalitete nga 47 vende të botës. Ky tubim ishte evenimenti i 15-të i grupit MEK, por i pari i organizuar në Shqipëri. Dy temat kryesore që u trajtuan nga folësit e shumtë ishin lëvdatat për ndërtimin e kampit “Ashraf-3” dhe për organizimin e këtij evenimenti, si dhe dëshira për përmbysjen sa më të shpejtë të regjimit iranian. Qëllimi kryesor i MEK-ut është ndryshimi i regjimit, ndonëse objektivi zyrtar është të mbushja e boshllëkut që mund të lërë përmbysja e qeverisë iraniane, deri në zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe themelimin e një shteti laik. Në kuadër të këtij plani, Maryam Rajavi do të marrë detyrën epresidentes së zgjedhur deri në organizimin e zgjedhjeve. Znj. Rajavi, bashkëshortja e bashkëthemeluesit të MEK-ut, Massoud Rajavi, ishte folësja kryesore e evenimentit të organizuar ditën e shtunë. Gjatë fjalimit të saj, ajo u ndërpre disa herë nga thirrjet e forta “Irani! Maryam! Liri!” MEK-u nuk mbështet zyrtarisht politikën e brendshme të vendeve të tjera dhe Delegacioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës përbëhej nga figura të të gjithë spektrit politik. Megjithatë, në

fjalën e saj hyrëse, znj. Rajavi shprehu mbështetjen për presidentin Trump, i cili ka ofruar ndihmën e tij në ngritjen e profilit të MEK-ut, pas tërheqjes nga pakti bërthamor me Iranin vitin e kaluar. “Ne nuk do të heqim kurrë dorë nga beteja jonë,” - u shpreh znj. Rajavi. Ish-kryebashkiaku i Nju-Jorkut, Rudolph W. Giuliani, këshilltari ligjor i z. Trump tha: “Nuk kemi të bëjmë me një zgjedhje për rrëzimin e një diktatori, kur nuk e dimë nëse vendin e tij mund ta zë një udhëheqës edhe më i tmerrshëm, por kemi të bëjmë me një zgjedhje midis njërit prej sponsorizuesve më të përcudnuar të terrorizmit në botë në regjimin aktual të Iranit dhe MEK-ut që gati për të marrë frenat në dorë.”

Maryam Rajavi DO TA RIFITOJMË IRANIN!

Nga Faqja 3

... po i afrohet fundit dhe po lufton për t'i mbijetuar një krize që do të shpjerë drejt përmbysjes së tij.

Zgjidhja përfundimtare dhe e pamohueshme është përmbysja e diktaturës fetare në tërësinë e saj, në duart e popullit të Iranit dhe Rezistencës së tij.

Po! Ekziston një alternativë që dëshiron të sjellë lirinë përmes njësisë dhe, qyteteve rebele, si dhe Ushtrisë Çlirimtare. Kjo alternativë është e aftë të themelojë një republikë demokratike dhe pluraliste mbështetur në ndarjen e fesë nga shteti, barazinë gjinore, autonominë e grupeve etnike të Iranit dhe në një Iran jobërthamor. Këshilli Kombëtar i Rezistencës së Iranit ka plane dhe programe konkrete. Falë organizimit dhe unitetit të tij, ky këshill mund ta zëvendësojë regjimin dhe të sigurojë kalimin paqësor të pushtetit në duart e përfaqësuesve të zgjedhur nga populli iranian. Po! Po afron dita kur Irani, Toka e Luanit dhe e Diellit, do të përqafojë lirinë.

Pra, ne do të këndojmë njëzëri teksa marshojmë drejt fitores: ne do ta rifitojmë Iranin dhe do të ndërtojmë një atdhe të ri!

Maryam Rajavi

Presidente e Zgjedhur e Këshillit Kombëtar të Rezistencës Iraniane (NCRI)

DO TA RIFITOJMË IRANIN!



Para njëzet muajsh, ky vend nuk ishte asgjë tjetër përveçse një copë tokë. Megjithatë, me përpjekjet e tyre të pareshtura dhe punën e palodhur, muxhahedinët ndërtuan kampin “Ashraf 3”, që tani ngrihet krenar dhe i papërkulur.

Sidoqoftë, destinacioni ynë i fundit është Teherani i lirë pushtimi i mullahëve, që kanë shkatërruar atdheun tonë, të cilin do ta rifitojmë dhe do ta rindëtojmë, duke e shndërruar në një vendin më të bukur.

Këtë rrugëtim e nisëm më 20 qershor 1981, kur udhëheqësi i Rezistencës Iraniane, Massoud Rajavi, nxiti një rezistencë të rrënjësor dhe të palëkundur kundër diktaturës fetare të mullahëve.

Ai themeloi Këshillin Kombëtar të Rezistencës së Iranit

(NCRI) dhe Ushtrinë Nacionalçlirimtare të Iranit (NLA).

Sot, “Ashraf 3” ngrihet krenar dhe i papërkulur në këtë rrugëtim të gjatë, me shumë fillime të reja dhe ringjallje. Në këtë rrugëtim, iu kemi bërë ballë dhjetë vjetëve gjakderdhje, të rrethuar në Kampin “Ashraf” dhe katër vjetëve të tjera plot vendosmëri në një thertore, të quajtur Kampi “Liria” (në Irak).

Sot, shënohet një tjetër kre në marshimin e madh drejt lirisë, çlirimit të Iranit, drejt një destinacioni të lavdishëm, sigurisht pas shumë vuajtjesh të papërshkrueshme dhe gjakut të derdhur nga martirët.

Sot, fashizmit fetar të mullahëve i ka ardhur fundi.

Në faqen 2





“Do t’ju përkrahim në çdo hap që do të hidhni”



Joseph Lieberman,

Ish-senator i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Nuk ndihem vetëm i nderuar, por edhe i emocionuar të jem këtu midis jush në kampin “Ashraf 3”.

Këtë fundjavë u njohëm me ju. Ju jeni njerëz të vërtetë. I kemi dëgjuar historitë tuaja. Ju e keni rritur angazhimin tonë për t’ju përkrahur në çdo hap të rrugës, duke nisur nga ferri në Kampin “Liberty” deri në parajsën në Iranin e çliruar.

Një lëvizje ka nevojë për një udhëheqës parimor, bashkëpunues dhe të fuqishëm. Falë Zotit, të gjitha këto virtyte i gjeni te znj. Maryam Rajavi. Ajo është parimore, largpamëse, altruiste dhe e aftë, si dhe për të, ju jeni të gjithë keni rëndësi. Dje, bashkë me time shoqe po bisedonim me znj. Rajavi mbi këtë ekspozitë dhe

mbi 120,000 martirët. Mënyra se si i shikonte ato fotografi... dukej sikur po ecnim përmes muzeut të Holokaustit. Ajo nuk la asnjë fytirë pa këqyrur, njëllë si të ishin familjarët e saj. Pra, këto janë ndjenjat e znj. Rajavi ndaj të gjithëve ju dhe ndaj çdo qytetari dhe qytetareje të Iranit. Jeni vërtet të bekuar që keni një udhëheqëse të tillë. Kësisoj, unë dhe të gjithë miqtë e mi në Amerikë dhe nga e gjithë bota e kemi më të lehtë për t’ju përkrahur drejt fitores. Dhe tani le t’i hedhim një vështrim historisë së kësaj lëvizjeje.

“Zonja Rajavi, plani juaj me 10 pika është e ardhmja”

Stephen Harper,
Kryeministri i 22-të i Kanadasë

Të gjithë u mahnitëm me gjithçka që ju keni ndërtuar këtu në kampin “Ashraf 3”. Oh, çfarë arritjeje e jashtëzakonshme! Përgëzime! Zonja Rajavi, të nderuar të ftuar, zonja dhe zotërinj, miq, jam shumë i lumtur që jam sërish sot në mesin tuaj, në Këshillin Kombëtar të Rezistencës për Iranin e Lirë 2019. E them këtë sepse në botë sot shumë pak kauza mund të jenë më të rëndësishme se kauza juaj: e drejta e popullit të Iranit për të ndryshuar qeverinë. Gjatë këtyre viteve, që prej mbledhjes sonë të fundit, regjimi i Ajatollahut është pasuruar sheshazi dhe ndjeshëm nëpërmjet uranit. Në të njëjtën kohë, ka përforcuar mbështetjen për aleatët dhe të deleguarit e tij terroristë në Lindjen e Mesme dhe në mbarë botën. Shkelja e të drejtave të njeriut ka arritur nivele të papërfytyrueshme. Pra, si kurrë më parë, Irani ka nevojë për ndryshim dhe punën e kësaj organizate në emër të popullit.

John Bird,
Ish-Ministër i Jashtëm i Kanadasë





Ta bëjmë të qartë: Ekziston një alternativë ndaj këtij regjimi të tmerrshëm terrori!



Rudy Giuliani,

Avokat i Presidentit të SHBA-së, Ish-Kryebashkiak i Nju-Jorkut (1994-2001)

vetëm, dhe sot në këtë sallë, ndjej një lloj optimizmi, të cilin nuk më kujtohet ta kem ndjerë kur ishim në Paris. Ndjem optimist, ndoshta ngaqë kjo që keni bërë në Ashraf është vërtet një mrekulli.

Sigurisht, gjithçka është e mundur falë udhëheqjes së zonjës Maryam Rajavi, një udhëheqëse e pashoqe. Së dyti, dua ta bëj të qartë se ekziston një alternativë ndaj këtij regjimi të tmerrshëm terrori. Nuk kemi të bëjmë me një zgjedhje për rrëzimin e për sa i përket rrëzimit të një diktatori, kur nuk e dimë nëse jemi të sigurt se vendin e tij mund ta zërrë një udhëheqës edhe akoma dhe më i tmerrshëm. Kjo ndodhi në Egjipt dhe në njëfarë mënyre edhe në Libi. Por nuk është ky problemi ynë. Po përballemi me regjimin më të tmerrshëm në botë, sponsorizuesin më të madh të terrorizmit në botë. Por, ne kemi edhe Këshillin Kombëtar të Rezistencës së Iranit, NCRI, udhëhequr nga presidentja e zgjedhur, znj. Rajavi. Koalicioni i

organizatave të rezistencës gëzon respekt anembanë botës. Sot në këtë kamp janë mbledhur përfaqësues të shumicës së vendeve kryesore në botë, të cilëve u është dhënë mundësia ta njohin dhe ta respektojnë udhëheqësen tuaj. Në vendin tim, ajo gëzon një respekt të jashtëzakonshëm.

Unë kam kaluar shumë kohë pranë banorëve të Ashrafit dhe mund të them se këta njerëz i janë përkushtuar lirisë. E dimë që ekziston një qeveri në mërgim, që bën negociata me të gjithë botën, dhe duket sheshazi se çfarë përfaqëson. Ajo ngjason me Kartën tonë të të Drejtave, me deklaratat universale për lirinë, dinjitetin dhe të drejtat e njeriut, të ruajtura në dokumentet e vjera të mbarë botës. Premtimi i saj është se zgjedhjet e lira do të mbahen brenda gjashtë muajve dhe unë besoj fort se do ta mbajë. Këto zgjedhje do të zhvillohen për hir të barazisë gjinore, të të drejtave të njeriut dhe sistemit të së drejtës. Ato i kushtohen një gjykimi sa më të drejtë. Ne mundemi ta mbështesim këtë grup. Është një grup ndaj të cilit nuk duhet të tregohemi keqdashës, por të ndjehemi të qetë për përmbysjen e regjimit më të keq që mund të ekzistojë në botë.

Por pak më parë ju thashë se çfarë di dhe çfarë ndjej. E kuptoj përse në këtë sallë ka kaq shumë optimizëm. Arsyeja është se ne do të shkojmë në Teheran shumë më shpejt nga sa mendojnë ata cinikë. E dini përse? Sepse jemi hazer, hazer, hazer. (Jemi gati).





JU KEMI DHËNË BESËN E SHQIPTARIT! Ambasadori dhe zv. Ambasadori i Iranit u dëbuan



Dhe pikërisht kjo është arsyeja përse jemi mbledhur të gjithë këtu së bashku për të festuar në një aktivitet të tillë, pasi se ju na keni nderuar me ndërtimin e kampit të mrekullueshëm "Ashraf 3", i cili luan rolin e një institucioni të vërtetë miqësie mes nesh. Uroj që shumë shpejt do të mund të vijmë dhe t'ju vizitojmë në Teheran.

Pandeli Majko,
Ministri i Shtetit për
Diasporën
Ish-Kryeministër i
Shqipërisë

Të dashur miq, e nderuar zonja Rajavi, dje, unë me kryebashkiakun Giuliani, bashkëshorten e tij, dhe kryeministrin Rama, treguam disa histori të vjetra për Luftën e Dytë Botërore, një kohë që është trashëguar brez pas brezi këtu në Shqipëri. Shtëpia e shqiptarit i përket Zotit dhe mikut që i troket në derë. Me të hyrë në shtëpinë tonë, ju kemi dhënë besën e shqiptarit. Kjo është arsyeja pse të gjithë shqiptarët ju bashkohen në kampin "Ashraf 3". Ju besoj e dini se kohët e fundit politikanët shqiptarë janë përfshirë në debate të forta, ndonjëherë edhe të zjarra, por kurrë për sa i përket qëndrimit tuaj këtu, sepse ju kemi dhënë besën e shqiptarit dhe kjo është tradita jonë. Sigurisht nga Teherani zyrtar na kanë ardhur fjalë të shumta,

të cilat janë shumë modeste përballë shoqërisë iraniane. Ne u përgjigjemi kështu: Bomba bërthamore që rrezikon lirinë, jo. Pagimi i regjimit të Sirisë që rrezikon lirinë, jo. Kthimi i zonjës Rajavi në Iran do të thotë se të gjitha paratë që paguani për të krijuar probleme për të tjerët, do t'u kthehen familjeve iraniane. Kjo është përgjigjja jonë e qartë.

Nëse kërkojnë ta ngrenë sërish çështjen e qëndrimit tuaj në Shqipëri, ata duhet të kujtojnë që ambasadori dhe zëvendësambasadori i Iranit tanimë janë dëbuar.

Mos na nxisni! Mos na nxisni më shumë, sepse jemi gati të përsërisim shprehjen që shqiptarët përdorën në Berlin gjatë Luftës së Dytë Botërore "Ar po, muxhahedinët janë miqtë tanë". Dhe pikërisht kjo është arsyeja përse jemi Arsyeja pse jemi mbledhur të gjithë këtu së bashkubashkë, për të festuar kremtuar në nderuar një aktivitet të tillë, është pasi se ju na keni nderuar neve me ndërtimin e kampit të mrekullueshëm kompleksit të bukur "Ashraf 3", i cili luan rolin e një institucioni të vërtetë miqësie mes nesh. Uroj që shumë shpejt do të mund të vijmë dhe t'ju vizitojmë në Teheran.





JU PËRFAQËSONI IRANIN NË KËTË VEND

Regjimi iranian është shtypës dhe kriminal

**Sali
Berisha,**
Ish-President
dhe
Kryeministër
i Shqipërisë



Zonja Presidente Rajavi, miq të dashur të lëvizjeve muxhahedine, miq të lëvizjes për liri nga mbarë bota, është një nder dhe kënaqësi e madhe për mua që t'ju përsëndes juve, popullin që ka luftuar për dekada të tëra për liri dhe të drejtat e njeriut në vend. Një popull që përballat me vështirësi nga më të papërfytyrueshmet, por që nuk resht së luftuari. Një popull që ka historinë e një njerke të ligë, por me lirinë përkrah tij. Me qëndrimin dhe betejën tuaj, ju frymëzoni çdo qenie njerëzore. Para disa vitesh, mora pjesë në takimin dhe kremtimin tuaj të madh, të organizuar në Paris. Asokohe, fuqitë e mëdha po negocionin me Iranin për të arritur një marrëveshje. Mendova: “Sa të vështirë e kanë këta njerëz që luftojnë kundër këtij regjimi!” Disa vite më vonë, koha tregoi se ju kishit të drejtë. Regjimi iranian është një regjim mashtrues, kriminal dhe i pabesë. Ju jeni shpresa e popullit tuaj.

Sot, mullahët quhen Komeinë ose çfarëdoqoftë. Në fakt, ata janë thuajse identikë me Al Bagdadin, forcën Al Bagdadi për kalifatin. Mullahët po luftojnë për kalifatin Shia, po pushtojnë kombet e tjera, po kërcënojnë paqen dhe themelet e tregtisë në botë. Kjo është arsyeja përse misioni

juaj është jo vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar. Jam i lumtur që para shumë kohësh mora vendimin e duhur. Dhe mendoj... në vendin tim.

Shqipëria e dëboi ambasadorin iranian, por duhet dhe do të dëbojë të gjithë përfaqësuesit zyrtarë të mullahëve. Jeni ju ata që e përfaqësoni Iranin, ndaj ata nuk e kanë vendin këtu. Miq të dashur, e kam parë dhe e kam analizuar shumë herë planin me dhjetë pika të zonjës Presidente Rajavi. Është një plan i frymëzuar nga idealet e 100,000 martirëve tuaj. Ky plan bazohet në vlerat universale, falë së cilave vendet dhe shoqëritë janë të lira dhe të madhërishe. Falë këtij plani, Irani do të shndërrohet në një vend të rëndësishëm, në një mik të ngushtë të popujve të lirë. Së fundi, unë ju mbështes plotësisht dhe jam i bindur se ju do të triumfoni në Iran.

Mullahët kanë treguar se nuk kanë as besim, as parime dhe se po vënë në rrezik sigurinë e rajonit. Nga njëra anë, nënshkruajnë marrëveshje për ndalimin e pasurimit me uran dhe nga ana tjetër, po i rrisin kapacitetet e raketave të tyre, me qëllim kërcënimin e popujve të lirë. Herët a vonë, ata do të marrin atë që meritojnë. Kalifati i mullahëve nuk ka për të triumfuar kurrë as në rajon dhe as në botë.







Unë e mbështes Zonjën Rajavi për punën e jashtëzakonshme që ka bërë



Elona Gjebrea,

Sekretare e Komisionit të Punëve të Jashtme në Kuvendin e Shqipërisë

Të dashur motra e vëllezër, të nderuar të ftuar dhe e nderuara Zonja Rajavi! Është një nder shumë i madh për mua të jem në këtë vend kaq të mrekullueshëm. Gjithashtu, do doja t'ju falënderoja të gjithëve që e keni bërë këtë vend kaq madhështor. Komuniteti ndërkombëtar duhet t'i njohë të drejtat e popullit iranian dhe rezistencën për të vendosur lirinë dhe demokracinë në atdheun e tyre, Iranin. Kampi "Ashraf 3" është simbol i lirisë dhe të ardhmes. Kur nisi zhvendosja e njerëzve të MEK-ut në Shqipëri, me mbështetjen e qeverisë shqiptare dhe padysim, nën drejtimin e kryeministrit tonë, z. Edi Rama, unë kam qenë zv. Ministre e Punëve të Brendshme. U ndjeva shumë mirë me faktin që të gjithë ishin të sigurt dhe të bashkuar këtu, në vendin tonë të bukur, Shqipërinë.

Muajin e kaluar, Shqipëria mbajti që qëndrim të fortë ndaj regjimit iranian dhe sulmit terrorist në Lindjen e Mesme. Kryeministri ynë deklaroi zyrtarisht se kërcënimet në Gjirin e Omanit përbëjnë një rrezik serioz për paqen ndërkombëtare dhe sigurinë e energjisë. Shqipëria qëndron përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe Emirateve të Bashkuara

Arabe kundër atyre që duket se janë provokime tipike të Iranit për të përshkallëzuar tensionet në botë.

Të dashur vëllezër, motra dhe miq, ne e mbështesim MEK-un dhe të gjitha përpjekjet që ka bërë për të arritur sigurinë dhe paqen në vend. Dosja për abuzimin e të drejtave të njeriut dhe masakrimet e të burgosurve politikë në Iran duhet të përcillen patjetër pranë Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Unë e mbështes Zonjën Rajavi për punën e jashtëzakonshme që ka bërë për një vend të sigurt dhe demokratik. Ajo është e ndjeshme, është e bukur si brenda dhe jashtë, dhe unë ju falënderoj për këtë. I mbështes me krenari gratë iraniane që kërkojnë ndryshim dhe demokraci në vendin e tyre. E admiroj guximin dhe vendosmërinë e tyre.

Siç e përmendën edhe kolegët e mi, ne, në vendin tonë kemi mospajtime, por që të gjithë jemi të bashkuar kur bëhet fjalë për kauzën e MEK-ut. Populli shqiptar i mbështet njerëzit e MEK-ut në Shqipëri për të gjitha përpjekjet që ata po bëjnë për të vendosur lirinë, paqen dhe sigurinë në vend. Ne duam vërtet t'i ndihmojmë ata. Ndihej vërtet e nderuar dhe e lumtur kur shikoj se sa shumë njerëz kanë ardhur në vendin tonë të bukur, Shqipërinë, që ka bërë shumë përparime gjatë këtyre viteve. Mendoj se e meritojmë të jemi anëtarë të Evropës. Ju faleminderit shumë!



Mirë se erdhët në fillimin e Iranit të lirë këtu, në Ashraf 3



Fatmir Mediu,

**Kryetar i Partisë Republikane të
Shqipërisë**

Ju faleminderit shumë! E nderuara zonja Rajavi, të dashur miq nga e gjithë bota, mirë se vini në Shqipëri dhe mirë se vini në fillimin e Iranit të lirë në Ashraf 3.

Dua të falënderoj MEK-un dhe KKRI-në që mbledhi miq nga e gjithë bota këtu në Shqipëri. Kjo është një dhuratë e veçantë për shqiptarët. Dje dhe sot, ne dëgjuam kryebashkiakun Giuliani, senatorin Lieberman, Michel Ario Mari dhe shumë personalitete të tjera që folën lidhur me atë se çfarë mund të bëhet më tepër, cili mund të jetë hapi i radhës... Pikërisht për këtë duhet të mendojmë edhe ne. Besoj se të gjithë jemi dakord për një gjë: Ndryshimi në Iran duhet të kishte ndodhur prej kohësh tashmë. Qeveria amerikane është ngritur kundër regjimit të Iranit dhe të gjithë shpresojmë dhe dëshirojmë që Bashkimi Evropian dhe vendet evropiane do të qëndrojnë të bashkuar, pasi mbështesin vlerat demokratike, të drejtat e njeriut dhe lirinë. Ata duhet të përkrahin çlirimin dhe lirinë e popullit të Iranit, si një të drejtë që e ka dhuruar Zoti.

Vitin e shkuar, qeveria shqiptare dëboi ambasadorin dhe zëvendësambasadorin iranian, krahas arrestimit të shumë të tjerëve, sepse kishin planifikuar një sulm terrorist kundër banorëve të kampit "Ashraf 3", kur u mbledhëm së bashku me kryebashkiakun Giuliani për të diskutuar mbi të ardhmen e Iranit. Ata nuk do të heqin dorë kurrë dhe do të bëjnë çmos për të krijuar probleme

dhe telashe për njerëzit që ndodhen këtu. Ata mund ta bëjnë këtë përmes medias ose veprimeve, por në do të qëndrojmë gjithmonë të bashkuar dhe do t'i ndalojmë. Ne duhet t'u japim terroristëve dhe përkrahësve shtetërorë të terrorizmit emrin që meritojnë.

Zonja Rajavi, plani juaj me 10 pika, është padyshim zgjidhja e duhur për Iranin e lirë. Në të njëjtën kohë, është një frymëzim për të gjithë njerëzit që besojnë në të drejtat që u ka dhuruar Zoti, në liri, pavarësi dhe kërkimin e lumturisë. Siç e përmendi edhe z. Majko, në Shqipëri kemi mosmarrëveshje politike, debatojmë fort çdo ditë, si dhe përballemi me konflikte politike, por kur bëhet fjalë për kauzën tuaj, për t'ju mbështetur për Iranin të lirë, ne bashkohemi dhe nuk ka më dallime mes nesh.

Dua ta përmbyll këtë fjalim duke thënë se është më mirë të kujtohem si populli që luftoi bashkë me ju për lirinë e popullit tuaj, për lirinë dhe pavarësinë e popullit iranian, se sa si populli që qëndroi duarkryq dhe bëri sehir duke parë shtypjen, vrasjet, terrorizmin. Ne nuk duam të jemi vëzhgues të historisë, por ne duam ta shkruajmë vetë historinë.

Zoti ju bekoftë të gjithëve! Shumë faleminderit!

Madame Rajavi, your 10-point plan is for sure the way for a free Iran. At the same time, it's an aspiration for all the people that do believe in God-given rights, in freedom and liberty and pursuit of happiness.

Përfaqësuesi Lance Gooden (R-TX), Komiteti për Shërbimet Financiare
‘Regjimi në Iran duhet të ndryshojë tani’



Dua t’ju tregoj disa gjëra që i kam mësuar gjatë shtatë muajve të parë pas marrjes së detyrës. Pikë së pari, mësova është se znj. Rajavi është një nga personat më të respektuar nga Irani në mbarë Shtetet e Bashkuara të Amerikës... Së dyti, mësova se pavarësisht mosmarrëveshkeve që kemi në Uashington dhe krahas çështjeve për të cilat ne shpesh nuk biem dakord, një nga çështjet për të cilën të gjithë Kongresin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës jemi në një mendje, dhe për të cilën presidenti Donald Trump na qëndron gjithnjë përkrah duke na udhëhequr, është se regjimi në Iran duhet të ndryshojë medoemos.

Gjenerali i dalë në pension George W. Casey Jr, Shefi 36-të i Shtabit të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara
‘Ndryshimi në Iran do të vijë vetëm falë jush’



Më lejoni ta mbyll me disa komente drejtuar banorëve të kampit “Ashraf 3”, Ashrafisëve. Ju keni ndërtuar shpërblimin e guximit. Ky është shpërblimi i vendosmërisë suaj. Është haraçi i 168 shokëve, që dhanë jetën gjatë rrugëtimit për të ardhur këtu. Falë guximit dhe vendosmërisë suaj, ju e keni betonuar, si në kuptimin e mirëfilltë ashtu edhe në atë figurativ, kampin “Ashraf 3” si qendrën globale për rezistencën demokratike ndaj regjimit iranian. Ndryshimi do të vijë shumë shpejt në Iran, vetëm falë jush dhe asaj që keni bërë.



From Left: Gen. Casey, Louis Freeh, Giuliani, Lieberman, Senator Toricelli, Gen. Phillips, Tom Ridge, Bloomfield, Sheehan, Col. McKloski, Col. Martin.

**Michèle Alliot-Marie, Ish-Ministër i Jashtëm, i
Mbrotjës dhe Ish-Ministër i Brendshëm i Francës**

**‘Ju përfaqësoni një vizion
për bashkimin e të gjithë**



**Bernard Kouchner,
Ish-Ministër i Jashtëm i Francës**

**‘Po përballemi me epokën e
lirisë në Iran’**



RAJONI I PARË I PARISIT SI QYTETI SIMOTËR I “ASHRAF 3”



**Kryebashkiaku Legaret i prezantoi një pllakë znjsh.
Zohreh Akhyani, Sekretare e Përgjithshme e PMOI/
MEK (2011-2017), duke e deklaruar rajonin e parë të
Parisit si qytetin simotër të Ashraf3**

Jean-François Legaret, kryebashkiaku i rajonit të parë të Parisit: “Ne kemi vendosur ta deklarojmë kampin “Ashraf 3” qytetin e dialogut ndërkombëtar dhe një qytet simotër me rajonin e parë Arrondissement në Paris. Ne duam të nënshkruajmë një deklaratë me kryebashkiakun e “Ashraf 3”. Premtojmë se do ta ruajmë dialogun mes bashkive tona dhe “Ashraf 3”. Mbetë shumë i kënaqur nga të gjithë kolegët e mi për deklaratat që dhanë.”



Tubim për Iranin e Lirë 2019 në Kampin “Ashraf 3”, Shqipëri

IRANI: PUSHTETI I ALTERNATIVËS!



Më shumë se 300 personalitete të shquara dhe Delegacione nga 50 vende të botës vizituan më 13 korrik 2019, “Ashraf 3”, shtëpinë e Rezistencës Iraniane në Shqipëri. Ky tubim ishte evenimenti i 15-të “Irani i Lirë” i PMOI-së (Muxhahedinët e Popullit të Iranit), por i pari i organizuar në Shqipëri.

DITA 1

Politika për Iranin dhe Alternativa e Qëndrueshme

Më 11 korrik të vitit 2019, në kampin “Ashraf 3” u organizua një konferencë e rëndësishme ndërkombëtare me temën “Politika për Iranin dhe Alternativa e Qëndrueshme”. Folësit e shquar, si: kryebashkiaku Rudy Giuliani, ish-kryebashkiak i Nju Jorkut; Ambasadori Lincoln Bloomfield, ish-Ndihmës Sekretari i Shtetit të SHBA-së; Gjenerali James Conway, Ish-Komandant i Trupave të Marinës së SHBA-së; Ivan Sascha Sheehan, Universiteti i Baltimorës; Ambasadori Robert Joseph, Ish-Nënsekretari Amerikan i Shtetit për Kontrollin e Armëve; I Nderuari John Baird, Ish-Ministër i Kanadasë; Senatori Robert Torricelli, Ish-Senator i Shteteve të Bashkuara diskutuan alternativat e politikës për SHBA-në, Evropën dhe aleatët e tyre që punojnë për krizën iraniane. Krahës kësaj, ata pasqyruan rolin që do të kishte Opozita Demokratike Iraniane, Organizata e Muxhahedinëve të Popullit të Iranit (PMOI) në të ardhmen e vendit.



Tubim për Iranin e Lirë 2019 në Kampin “Ashraf 3”, Shqipëri

IRANI: PUSHTETI I ALTERNATIVËS!

Ekspozita pasqyron vuajtjet dhe vendosmërinë për të pasur sukses

DITA 2

Në kampin “Ashraf 3”, Shqipëri, po organizohet një nderim historik për mijëra heronjtë që dhanë jetën për kauzën e lirisë dhe demokracisë në Iran. Qëllimi i ekspozitës është të rrëfejë një histori shumë prekëse vuajtjesh, por në të njëjtën kohë, të tregojë vendosmërinë e popullit iranian për të vendosur demokracinë me çdo kusht. Salla e madhe e ekspozitës quhet “Zohreh” për nder të Zohreh Gha’emi, një anëtare të lartë të udhëheqjes së MEK-ut, i cili u vra nga regjimi iranian në shtator të vitit 2013. Në të ekspozohen fotografi dhe simbole të “120 viteve të Luftës së Popullit Iranian për liri.” Në hyrje gjenden portretet e mëdha të themeluesve fillestarë të MEK-ut dhe udhëheqës të lëvizjeve të ndryshme demokratike, që luftonin kundër diktaturës së Shahut dhe tiranisë së mullahëve. Këtu përfshihen edhe udhëheqësit e Revolucionit Kushtetues, si dhe Kryeministri i nderuar Dr. Muhamed Mosadek. Në muret 3.5 metra të gjatë që rrethojnë të dyja anët e udhëve të gjata shfaqen mijëra portrete të qeshura të të rinjve, fëmijëve, nënave e baballarëve, mjekëve, studentëve dhe aktivistëve, të cilët u vranë brutalisht, sepse mbështesnin lirinë dhe pavarësinë. Me dhjetëra protestues që kanë rënë dëshmorë që prej vitit 1981 janë nderuar bashkë me 120,000 anëtarët e MEK-ut, të cilët janë vrarë nga duart e regjimit klerik që prej vitit 1979. Detajet e personave të vrarë, përfshirë edhe vajza të moshës 13-vjeçare, janë gdhendur në muret e mëdha, në të cilën pasqyrohet edhe një hartë për çdo provincë, shoqëruar me qindra emra dhe fotografi. Objektet përkujtimore dhe artefaktet artizanale të të burgosurve politikë, nënat dhe baballarët e torturuar për besimin e tyre, janë objekte të gjalla dhe emocionale që na sjellin ndër mend rezistencën dhe këmbënguljen, pavarësisht se gjithçka ishte kundër tyre. Në këtë muze shfaqen edhe qeli të tmerrshme burgu me përmasa reale, si dhe imitime e modele realiste që rrëfejné se si regjimi iranian ekzekutoi brutalisht 30,000 të burgosurit politikë. Në një nga imitimet tregohet se gratë detyroheshin të rrinin deri në tetë muaj në një hapësirë me përmasa 1:1 metër të quajtur “kafaz”. Ato i humbisnin të gjitha ndjesitë trupore, dhe me t’u ngritur i humbnin ndjenjat, ngaqë kishin qëndruar për një kohë të gjatë të ulur në bisht në një hapësirë kaq të vogël. Gjithashtu, detyroheshin të duronin tortura të jashtëzakonshme psikologjike, madje shumë prej tyre filluan të vuanin nga probleme mendore akute. Burgosjet dhe ekzekutimet çnjerëzore të regjimit iranian janë shembuj të qartë të krimeve të kryera kundër njerëzimit. Reagimi frymëzues i popullit iranian dhe i Rezistencës Iraniane, që u nxit nga fryma e pashtershme e vendosmërisë, tregon se Irani do të jetë i lirë.



Tubim për Iranin e Lirë 2019 në Kampin “Ashraf 3”, Shqipëri

IRANI: PUSHTETI I ALTERNATIVËS!

DITA 3

Parlamentarët britanikë ndërpartiakë mbështesin Rezistencën

Matthew Offord-i, Anëtar i Parlamentit Britanik ka thënë: Ju, që jeni angazhuar në lëvizjen e rezistencës të udhëhequr nga zonja Rajavi, jeni në vijën e parë të frontit të luftës për një Iran të lirë e demokratik. Ju jeni drita e shpresës për miliona njerëz të shtypur në Iran.

Baronesha Verma, Anëtare e Shtëpisë Britanike të Lordëve: “Gratë e guximshme i janë bashkuar burrave për të sfiduar një regjim të tërë.”

Delegacioni Evropian

Alejo Vidal-Quadras, ish-Anëtar i Parlamentit Evropian: Gjithë për këtë makth është gati. Është NCRI-ja dhe udhëheqësja jonë, Maryam Rajavi. Ashrafi tjetër është në rrugë e sipër dhe asgjë e askush nuk mund ta ndalojë. Ai quhet Iran. Ashraf 1, 2 dhe 3 janë vetëm një Ashraf... Jemi mbledhur këtu sot për të thënë se nuk do të ketë një Ashraf 4, sepse Ashrafi tjetër e ka një emër, i cili është i bekuar nga mijëra vite histori, qindra breza njerëzit të rëndësishëm, një kulturë e mrekullueshme e krijuar nga artistë, shkrimtarë, muzikantë, mendimtarë, shkencëtarë, zejtarë, fermerë dhe tregtarë përgjatë shekujve. Ky emër është Iran. Vetë Irani do të jetë Ashrafi i fundit.

Koncert

Ashraf 3, 13 korrik, 2019 – Orkestra Simfonike e Radios dhe Televizionit kombëtar, e drejtuar nga Zhani Ciko, i cili deri në vitin 2013 ka qenë drejtori i Teatrit të Operës dhe Baletin në Shqipëri, dhe më pas, e drejtuar nga Mohammad Shams, kompozitori dhe dirigjenti i njohur iranian, luajtën disa vepra mahnitëse iraniane dhe klasike, përfshirë edhe shumë vepra popullore muzikore të kompozura fillimisht nga muzikantët e MEK-ut në vitet 1970-të. Kori u drejtua nga znj. Suzana Turku. Tri vokalistë të njohur shqiptarë, Armaldo Kllogjeri, Gerald Murrja dhe Erlind Zeraliu, kënduan shumë këngë. Z. Zeraliu këndoi veprën ikonike “My way,” të interpretuar më parë nga legjendari Frenk Sinatra.



IRANI: PUSHTETI I ALTERNATIVËS!

DITA 4

"Gratë në Rezistencën Iraniane sfidojnë regjimin misogynist dhe paguajnë çmimin e lirisë"

Më 14 korrik të vitit 2019, në "Ashraf 3" u organizua një konferencë ndërkombëtare me titull: "Gratë në Rezistencën Iraniane sfidojnë regjimin misogynist dhe paguajnë çmimin e lirisë". Në këtë konferencë morën pjesë aktivistët e të drejtave të grave dhe personalitete nga e gjithë bota, që ngritën zërin në mbështetje të grave të Iranit, të cilat kanë udhëhequr luftën e lirisë në Iran.

Konferenca ndërkombëtare

Në "Ashraf 3" u organizua një konferencë e rëndësishme ndërkombëtare për terrorizmin e regjimit iranian, programet bërthamore e të raketave, si dhe rolin e opozitës iraniane në ndryshimin e regjimit në Iran, me titull: "Irani: Mbështesni kryengritjet dhe Rezistencën e popullit dhe thojni jo terrorizmit të mullahëve, si dhe programeve bërthamore e të raketave".

Mbështetja nga Vendet Arabe:

Në panelin e ditës 4 të mbledhjes "Irani i lirë" i organizuar në Ashraf-3, shtëpia e anëtarëve të opozitës demokratike të Organizatës Muxhahedine të Popullit të Iranit, morën pjesë shumë personalitete arabe. Konferenca titullohej: "Solidariteti arab dhe islami me popullin iranian dhe alternativën demokratike".



DITA 5

Autorët e krimit të Masakrës së vitit 1988 në Iran duhet të dalin para përgjegjësisë

Të hënën, më 15 korrik 2019, Ditën 5 të mbledhjes "Irani i lirë" i organizuar në Ashraf 3, një panel ekspertësh dhe dëshmitarësh diskutuan masakrën e vitit 1988 dhe nevojë për ndjekjen penale në shkallë ndërkombëtare të të autorëve të krimit.

Autorët e krimeve kundër njerëzisë nuk kishin dalë kurrë para përgjegjësisë. Akoma dhe më i keq ishte fakti se ata ishin caktuar në pozicionet më të larta të qeverisë dhe sistemit gjyqësor iranian. Në verën e vitit 1988, regjimi i Iranit ekzekutoi me dhjetëra mijëra të burgosur politikë që mbaheshin nëpër burgjet e Iranit.



Kryeministri EDI RAMA:

Shqipëria ka vepruar me vendosmëri kundër veprimtarive të paligjshme të regjimit iranien



Në një fjalim të mbajtur të premten më 27 shtator të vitit 2019, në Asambelën e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Kryeministri shqiptar Edi Rama theksoi veprimtaritë e paligjshme dhe destabilizuese të regjimit iranien përfshirë edhe komplotet kundër anëtarëve të grupit kryesor opozitar iranien, Organizata e Muxhahedinëve të Popullit Iranian (PMOI, Mujahedin-e Khalq ose MEK), të cilët banojnë në Ashraf 3, Shqipëri. Kryeministri Rama u shpreh në Asambelën e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara: “Shqipëria është veçanërisht e shqetësuar për sjelljen destabilizuese të Iranit në Lindjen e Mesme, por edhe



për veprimtaritë përçarëse lidhur me komunitetin e opozitës iraniane, të cilat janë organizuar në vendin tonë pasi u janë nënshtruar masakrave të neveritshme diku gjetkë. Kryeministri theksoi: “Na është dashur të

ndërhyjmë me vendosmëri për një sërë veprimesh të paligjshme të Iranit kundër interesave tona kombëtare të sigurisë.” “Ne i përkrahim ato vende që janë lënduar dhe nga këto aktivitete, si në det ashtu edhe në tokë.”

ARCHIVE

Shqipëria dëboi ambasadorin iranien


Mbështetja e regjimit iranien për terrorizmin nuk do të tolerohet

19 dhjetor 2018 - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dëboi ambasadorin iranien, duke sinjalizuar në këtë mënyrë liderët iranien se mbështetja e tyre ndaj terrorizmit nuk do të tolerohet. Ne mbështesim kryeministrin Rama dhe popullin shqiptar për reagimin e tyre ndaj sjelljes së papërgjegjshme të Iranit në Evropë dhe në mbarë botën.

<https://twitter.com/AmbJohnBolton/status/1075494980922298370>

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, përgëzon Shqipërinë për dëbimin e ambasadorit dhe të një diplomati iranien

21 dhjetor 2018 - Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, i dërgoi një letër kryeministrin të Shqipërisë, Edi Rama, në të cilën përgëzon qeverinë e tij për dëbimin e ambasadorit dhe të një diplomati iranien. Kjo vjen pas disa tweet-eve të Këshilltarit të Sigurisë Kombëtare të SHBA-së, John Bolton, dhe Sekretarit të Shtetit Mike Pompeo, mbi këtë temë shumë të rëndësishme. <https://english.mojahedin.org/i/president-praises-albania-for-expelling-the-iranian->



Presidenti i Shqipërisë mbështet dëbimin e ambasadorit dhe diplomatit iranien

23 dhjetor 2018 - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka shprehur mbështetjen e tij të plotë për vendimin më të fundit për dëbimin e terroristëve diplomatë iranien nga vendi. Të shtunën, Meta e vendosi theksin te vendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë lidhur me dëbimin e ambasadorit dhe të një diplomati të Teheranit. <https://english.mojahedin.org/i/albanian-president-supports-expulsion-iranian-regime-ambassador-diplomat>

Presidenti shqiptar Ilir Meta viziton Ashraf 3 dhe takohet me znj. Rajavi

Botim i veçantë

nga faqja 20

dëbimi i ambasadorit të regjimit për përfshirje në terrorizëm, Shqipëri, shërben si një model për vendet e tjera. Presidentja e Zgjedhur e NCRI-së theksoi se diktatura fetare që sundon në Iran, nuk mund të reformohet. Shpresa për të ndryshuar sjelljen e saj nxit më tepër terrorizëm dhe fundamentalizëm. Meqenëse nuk mund të ndryshojë, përmbysja e këtij regjimi nga populli iranian dhe Rezistenca iraniane është e domosdoshme për paqen dhe stabilitetin rajonal e ndërkombëtar. Presidenti Meta shkroi në librin e kujtimeve të hapur në këtë ekspozitë për nder të martirëve të Rezistencës Iraniane fjalët: “Ishte një përvojë e jashtëzakonshme për mua që u njoha me sakrificat e paimagjinueshme të kësaj lëvizjeje për liri dhe drejtësi sociale. Ne do të ndihemi krenarë që bëmë çmos që ju të shijoni lirinë. Deri atëherë, ky vend ka për të qenë shtëpia juaj...:”

Sekretariati i Këshillit Kombëtar të Rezistencës së Iranit
13 shtator, 2019



Ishte kënaqësi e veçantë të vizitoja Znj. Maryam Rajavi, Presidenten e Zgjedhur të Këshillit Kombëtar të Rezistencës së Iranit dhe të njihesha me planin e saj prej 10 pikash, bazuar në vlerat e lirive themelore, votës së lirë, shtetit të së drejtës, përfshirjes sociale që synojnë ndërtimin e një shoqërie të begatë dhe demokratike për popullin e Iranit. Solidarizohem me vuajtjet, sakrificat, vështirësitë e papërshkrueshme që këta njerëz kanë kaluar dhe me të gjitha përpjekjet për kauzën e tyre të rëndësishme për demokraci dhe drejtësi sociale. Mikpritja dhe solidariteti i popullit shqiptar për këta njerëz mishëron më së miri mësimet e Shenjtores Nënë Tereza, simbolit shqiptar dhe botëror të dashurisë, humanizmit dhe solidaritetit njerëzor që të tregojmë përkujdesje e vëmendje, të ndodhemi pranë kujtudo që ka nevojë për ndihmë dhe solidaritet për të lehtësuar sa të mundim brengën e sakrificës së tyre.

PRESIDENT ILIR META



Presidenti shqiptar Ilir Meta viziton Ashraf 3 dhe takohet me znj. Rajavi

Botim i veçantë

META: Plani me dhjetë pika i Zonjës Rajavi bazohet në liritë themelore dhe do t'i sigurojnë popullit iranien begati dhe demokraci

Të premten më 13 shtator të vitit 2019, në mesditë, Shkëlqesia e tij, z. Ilir Meta, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, vizitoi kampin "Ashraf 3", shtëpinë e anëtarëve të Organizatës së Muxhahedinëve të Popullit Iranian (PMOI/MEK) në Shqipëri. Anëtarët e MEK-ut e mirëpritën me ngrohtësi presidentin shqiptar, i cili shoqërohej nga z. Fatmir Mediu, Kryetari i Partisë Republikane të Shqipërisë, si dhe z. Bahri Shaqiri, Këshilltari i Presidentit për Sigurinë Kombëtare.

Gjatë vizitës, Presidenti Meta u takua dhe bisedoi me znj. Maryam Rajavi, Presidenten e zgjedhur të Këshillit Kombëtar të Rezistencës së Iranit (NCRI), si dhe vizituan ekspozitën e hapur në Ashraf kushtuar 120 viteve të luftës për lirinë e Iranit.

Gjatë takimit me anëtarët e MEK-ut, Presidenti Meta tha: "Nuk e kisha idenë për sakrificat dhe gjenocidin e madh që keni vuajtur ju dhe mbështetësit tuaj. Ishte vërtet tronditëse kur pashë të masakruar kaq shumë njerëz, gra dhe fëmijë."

"Kjo tregon gjithashtu për shkallën e gjerë të përhapjes së lëvizjes në Iran, si dhe sa tiranik që është ky regjim. Kjo është e rrezikshme jo vetëm për popullin e Iranit, por edhe për paqen dhe stabilitetin rajonal e global. Mbete i mahnitur nga plani me dhjetë pika i Znj. Rajavi, sepse ai dhe do t'i sigurojë popullit iranien begati e demokraci. Të gjithë në Shqipëri bashkohemi për t'ju mbështetur në përpjekjet dhe vendosmërinë tuaj," theksoi presidenti Meta.

Znj. Rajavi e mirëpriti presidentin Meta dhe u shpreh se populli iranien nuk do ta harrojë kurrë mikpritjen e luftëtarëve iranienë për liri nga Shqipëria dhe se ky veprim do të rrënjoset në historinë e marrëdhënieve mes të dyja vendeve. Ajo shtoi se për sa i përket vendosmërisë karshi regjimit klerik, që pasqyrohej në...

Në faqen 19

